

## Fletë informacioni IAM Classic

### **Këshillim dhe mbështetje për politikat e tregut të punës për migrantet/ët dhe njerëzit me sfond migrimi**

Keni pyetje në lidhje me punën, stazhet, kurset e gjermanishtes, shkollim profesional, apo jeni duke kërkuar në mënyrë aktive një punë?

#### **Oferta jonë e këshillimit përfshin:**

- ▶ Këshillim për politikat e tregut të punës
- ▶ Kërkim pune
- ▶ Ndihmë për përgatitjen e dokumenteve të aplikimit
- ▶ Mbështetje në procesin e aplikimit dhe për kontaktet me kompanitë
- ▶ Person kontaktues për kompanitë (p.sh. sqarim i pyetjeve në lidhje me lejet e punësimit, informacion mbi lejet e qëndrimit dhe punësimin ose aksesin në tregun e punës, etj.)
- ▶ Shoqërim në intervistat e punës
- ▶ Këshillim për kurset e gjermanishtes (informacion për të gjitha kurset e ofruara)
- ▶ Informacion mbi shkollimin profesional, edukimin e mëtejshëm dhe kurset
- ▶ Mbështetje për njohjen dhe nostrifikimin e shkollimit profesional
- ▶ Këshillim për lejeqëndrimet
- ▶ Analiza e potencialit dhe e kompetencave
- ▶ Këshillimin për karrierë dhe kompetencë
- ▶ Lidhja me autoritetet dhe institucionet (bashkëpunim i ngushtë me AMS, zyrën e mirëqenies sociale, ÖIF, ofruesit e kurseve dhe shumë partnerë të tjerë bashkëpunimi)
- ▶ Mbështetje me tema specifike këshillimi si sqarime në lidhje me lejeqëndrimin/shërbimet bazë etj., informacion mbi temën e përkujdesjes së fëmijëve, ndihmë për temat e këshillimit specifike për gratë dhe, nëse është e nevojshme, përcjellja në organizata të veçanta etj.
- ▶ Informacion mbi projektin e kontrollit të kompetencës dhe shumë më tepër.

#### **Kush do të këshillohet?**

- ▶ Emigrantet/ët (BE, shtetas të vendeve të treta)
- ▶ Njerëz me sfond migrimi
- ▶ Personat me të drejtë azili

Mit finanzieller Unterstützung des

▶ Përfituesit e mbrojtjes plotësuese

Ju nuk i përkisni grupit të synuar të sipërpërmendur dhe keni nevojë për mbështetje? Ju jeni gjithsesi shumë të mirëpritur dhe ne do ju ndihmojmë me kënaqësi.

Kushtet për t'u pranuar në këshillimin tonë:

- ▶ Një qëndrim i ligjshëm në Kärnten ose në Austri
- ▶ Akses të lirë në tregun e punës
- ▶ Regjistrimi në AMS si punëkërkues dhe
- ▶ Një referencë nga AMS për tek këshillimi ynë.

**Si të vij në këshillim?**

1. Regjistrimi tek AMS  
Rezervim shtesë për IAM përmes këshilltares/it të AMS
2. Regjistrim tek IAM dhe lënia e një takimi

**Detajet tona të kontaktit:**

**IAM – Institut für Arbeitsmigration  
(Instituti për Migrimin për Punë)**

Gabelsbergerstraße 13

9020 Klagenfurt am Wörthersee

Tel: +43 (0) 463 509 301

Fax: +43 (0) 463 509 301-20

E-Mail: [info@iam.co.at](mailto:info@iam.co.at)

Ne ofrojmë konsultime në zyrat tona në (Gabelsbergerstraße 13, 9020 Klagenfurt a. W.) dhe Villach (Trattengasse 32/3.Stock, 9500 Villach), si dhe në zyrat rajonale të AMS në të gjithë Kärnten. Nëse keni ndonjë pyetje specifike në lidhje me takimet e këshillimit dhe ditët e konsultimit në rrethe, ju lutemi na kontaktoni në çdo kohë (mundësisht paraprakisht me telefon ose email)!

Organizata jonë është e hapur për ju çdo ditë nga ora 08:00.

**Takimet për këshillim lihen me telefon në numrin 0463 509301.**

Jeni të mirëpritur të na e dërgoni kërkesën tuaj edhe me email ([info@iam.co.at](mailto:info@iam.co.at)).

**Keni pyetje? Ju presim me kënaqësi!**

Mit finanzieller Unterstützung des



LAND  KÄRNTEN

Tel: 0463-509301, Fax: 0463 509301-20  
Email: [info@iam.co.at](mailto:info@iam.co.at)

Bankverbindung:  
Die Kärntner Sparkasse, BLZ 20706  
KtoNr. 4400-419620, KtoNr. 4400-419612  
ZVR-Zahl 235966940